

Data 25.04.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Kasaforta”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44421300-0

Kasaforta te Blinduara

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,417,996 (trembëdhjetë milion e katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH., vënë në dispozicion nga të ardhurat e vetë Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a ;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **”Posta Shqiptare” sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **268,360** (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

□ *operatorët ekonomikë duhet të jene të regjistruar në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë;*

Kjo pike plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre vitet e fundit 2021; 2022 dhe 2023, **ku të paktën në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 39% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 42, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se **39%** e vlerës limit të kontratës që prokurohet. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën e vlefshme, që vërteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë së tij është në përputhje me ISO 9001 – 2015 (ose ekuivalente) dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara.

(Certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Nisur nga fakti se pajisjet objekt prokurimi janë Kasaforta të sigurisë së lartë dhe të postës sekrete, të cilat shërbejnë për ruajtjen e vlerave monetare dhe të dokumentacionit të zyrave postare, si dhe fakti se pajisjet kanë një afat garancie në jo më pak se 5 (pesë) vite, dhe duke qenë së gjatë kësaj periudhe mund të ketë problem me pajisjen apo me bllokimin e kodit të dyerve (sikurse ka ndodhur edhe nga praktikat e mëpërparshme) kërkohet që operatori ofërtues të jetë sa më i kualifikuar, serioz dhe i besueshem. Për këtë arsye nga autoriteti kontraktor shikohet e nevojshme që operatorët ekonomik ofërtues të zotërojnë çertifikatat e poshtëshenuara, disponimi i të cilave krijon bindje tek autoriteti kontraktor se operatori ekonomi ofërtues ka kualifikimet minimale të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ky kriter është përcaktuar për arsye se: ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo çertifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.)

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën e vlefshme ISO 20000-1, Teknologji Informacioni (Menaxhim Shërbimi) (ose ekuivalente), të vlefshme për periudhen e prokurimit.

(Certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

ISO 20000-1, përcakton kërkesat për menaxhimin e shërbimit të Teknologjisë së Informacionit duke përcaktuar një grup të integruar procesesh për të mbështetur ofrimin efikas të shërbimit të klientit. Çertifikimi sipas ISO 20000-1 i jep kompanisë mundësinë për të demonstruar orientimin e klientit. Standarti mund të zbatohet dhe çertifikohet individualisht ose të integrohet me standarte të tjera si

ISO 27001 për Menaxhimin e sigurisë së Informacionit ose ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).

Zoterimi i një çertifikate në fjalë nga operatori ekonomik ofertues përbën një siguri në suportin dhe menaxhimin e shërbimit teknik që këto mallra kërkojnë gjatë përdorimit të tyre.

Duke qenë se pajisjet e kërkuara janë produkte sigurie, operatori ekonomik duhet të jetë sa më kompetent dhe bindës kjo e vërtetuar me çertifikatën e mësipërme.

Shërbimi do të konsistonte në trajnimin e përdorimit të këtyre pajisjeve, realizimin e zhbllokimit dhe riparimit të kodeve elektronike, si dhe programimin e tyre gjatë periudhes 5- vjeçare të garancisë dhe pas garancisë nëse është e domosdoshme.

Siç u tha më lart këto produkte janë të një karakteri sigurie që në vetvete do të ruajnë qoftë vlera monetare por dhe dokumentacionin, e për këtë ofertuesi dhe kontraktori i mundshëm duhet të zotërojë kapacitete teknike dhe çertifikimet e nevojshme për ofrimin e këtij shërbimi ç'ka kjo garanci shërbimi konfirmohet nese operatori ofertues është i çertifikuar nga një Institucion i Akredituar.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatë të vlefshme ISO 27001 (ose ekuivalente), për Menaxhimin e sigurisë së Informacionit, të vlefshme për periudhën e prokurimit.

(Certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit)

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

ISO 27001 është një nga standartet më të njohura ndërkombëtare për sigurinë e informacionit. Ai mund të zbatohet dhe të jepet për çdo kompani, pavarësisht nga aktiviteti i saj. Siguria e informacionit përcaktohet duke përdorur 3 elemente: konfidencialiteti (informacioni është i disponueshëm vetëm për personat e autorizuar); integriteti (informacioni është i plotë dhe i saktë) dhe disponueshmeria (personat e autorizuar mund t'i qasen informatave kur ata kanë nevojë.

Elementi kryesor i ISO 27001 është vlerësimi i rreziqeve të sigurisë që kompania duhet të ndërmarrë dhe vendosja e masave për adresimin e këtyre rreziqeve. Ekziston gjithashtu nevoja për objektiva të sigurisë, një politikë sigurie e miratuar nga udhëheqja e kompanisë, përgjegjësitë e personelit për menagjimin e sigurisë, auditimet e brendshme dhe rishikimet e menaxhimit.

Duke qenë se keto mallra janë të një karakteri sigurie që në vetvete do të ruajnë qoftë vlera monetare por dhe dokumentacionin që mund të jetë dhe kofidencial, informacioni në rast kur ndodh problem apo kërkesë për suport, këto pajisje duhet të shkojnë tek kontraktori ose hapen nga kontraktori. Informacioni Brenda këtyre mallrave mund të jetë kofidencial, dalja e të cilit do të mund të sillte dëme të pariparueshme. Për këtë arsye nga A.k. është vlerësuar e nevojshme që kontraktori i mundshëm të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Kjo për të krijuar bindjen se operatori ekonomik ofertues zotëron kualifikimet dhe certifikimet e duhura në këto aspekt.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose leter angazhimi ose akt marreveshje bashkëpunimi, midis prodhuesit/ve ose distributori dhe OE ofertues, për mallrat e kërkuara. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autorizimi i prodhuesit ose leter angazhimi ose akt marrëveshje bashkëpunimi, midis prodhuesit/ve ose distributori dhe OE ofertues, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës. Operatorët Ekonomike duhet specifikisht të paraqesin Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar përkatës me qellim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomike kanë të drejta për të rishitur këto produkte, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njejtët prodhues.

2.3.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të kërkuara, OE duhet të paraqesë katalogun ose fragmente të katalogut, ku të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen dhe kujt prodhuesi i përkasin.

Argumentimi:

Paraqitja në ofertë në formë elektronike e katalogut ose fragmente të katalogut, ku të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen dhe kujt prodhuesi i përkasin (Marka), ka rëndësi në vlerësimin e ofertës teknike, pasi duke krahasuar të dhenat teknike të katalogut me specifikimet teknike të DST-së, është më e qartë dhe më bindëse oferta dhe i shërben AK-së për të krijuar bindjen se produkti i ofruar është në përmbushje të plotë të specifikimeve teknike.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të provojë me dokumentacion se disponon të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar (*ku të dëshmojë se specialisti ka ndjekur kurs trainimi*) nga kompani ndërkombëtare ose **autoritete/institucione/ente të autorizuar** të tjera për lëshimin e certifikatave/dëshmimeve të formimeve të ndryshme profesionale për prodhimin e Bravave mekanike, elektronike që përdoren për kasaforta, specialisti i çertifikuar të jetë i përfshirë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) të ofertuesit për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 paragrafet b dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Kasafortat objekt kontrate shërbejnë për ruajtjen e vlerave monetare dhe të dokumentacionit tjetër të nevojshëm apo për transportin e postës sekrete të cilat duhet të qarkullojnë në një kohë të përcaktuar. Nisur nga praktika e viteve të mëparshme ku ka patur problem lidhur me bllokimin e kodit të dyerve të kasafortave ku në shumë raste duhet ndërhyrja e specializuar e punonjësve të shoqërive me të cilat kemi lidhur kontrata me të njejtin objekt prokurimi për hapjen e dyerve të blinduara, si dhe referuar faktit që malli objekt prokurimi kërkohet të ketë një periudhë garancie prej minimum 5 (pesë) vite nga moment i marrjes në dorëzimit, si dhe kërkesa që në rast bllokimi apo ndonjë defekti që mund të lindi brenda garancisë, kontraktuesi është i detyruar që brenda afateve që do të përcaktohen në kontratë, me specialistët e vet të riparojë defektin ose mundësojë zhbllokimin e dyerve, si dhe referuar sasisë së konsiderueshme të artikujve objekt kontrate, vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe intelektuale të dëshmojë se disponon të paktën 1 specialist të çertifikuar nga kompani ndërkombëtare prodhimi të Brava mekanike, elektronike që përdoren për kasaforta. Kjo kërkesë shikohet e nevojshme për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor se operatori ofertues zotëron kapacitet intelektuale në realizimin e kontratës si dhe në krijimin e garancisë dhe të besueshmerisë që të mund të mbulojë problemet teknike që mund të ndodhin gjatë periudhës së garancisë së mallit.

Nga gjithë eksperiencia dhe njohuritë që stafi teknik ka në fushën e sigurisë gjerësisht njihet dhe pranohet se asnjë prodhues kasafortash nuk prodhon bravat e tyre.

Nëse ne do të sjellim në vëmendjen tuaj prodhuesit me prestigjioz në botë që prodhojnë brava sigurie si “Sargent & Greenleaf, KaBa Mauer, Kavi, M-Lock, Mauer, SECO, etj asnjëri nga këto nuk prodhon kasaforta. E njejta gje mund të thuhet për prodhuesit e kasafortave ku asnjë nga këto nuk prodhon Brava Sigurie (Në dijenin tonë Askush).

Gjithashtu në dijeninë tonë nuk ekziston asnjë prodhues Kasafortash apo Bravash sigurie (Të certifikuar) në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kërkesa që operatori ekonomik të dëshmojë se ka të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga Prodhuesit Ndërkombëtar është një kriter që krijon bindjen e AK së Operatori Ekonomik ka aftësinë teknike dhe seriozitetin në fushën e kërkuar dhe siguron realizimin e plotë të kontratës përfshirë garancinë 5-Vjeçare të produkteve të ofruara.

- 3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër që me mjetet dhe shpenzimet e veta, të kryejë shërbimin e transportit të Kasafortave të mëdha 2 (dy) copë , sipas plan shpërndarjes si vijon: **1 (një) kasafortë të madhe në Filialin Durrës** zyra Qëndër në dhomën e sigurisë dhe **1 (një) kasafortë të madhe në Filialin Shkodër Malësi e Madhe** dhoma e sigurisë

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për “**Blerje Kasaforta**”, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit Nr. 25**, datë **29.03.2024**, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit **nr. 32**, datë **12.04.2024**, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76

“**Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “**Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlllogaritur vlerën limit të kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT